




PROGRAM ORIENTUES PËR TESTIMIN E INFORMATIZUAR “MËSUES PËR SHQIPËRINË” 2025

LËNDA HISTORI





TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES	1
HYRJE	2
QËLLIMI I PROGRAMIT	3
PËRMBAJTJA E PROGRAMIT.....	4
FUSHA: DOKUMENTE ZYRTARE	4
FUSHA: PROGRAME LËNDORE	6
FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK- UT NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE	7
FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT	9
FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE	10
FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS	10



HYRJE

Programi orientues për testimin e informatizuar “Mësues për Shqipërinë” të lëndës së historisë është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), për t’u ardhur në ndihmë të gjithë kandidatëve që duan të ushtrojnë profesionin e mësuesit në lëndën e historisë.

Ky program përfaqëson dhe përmbush, njëherazi, kurrikulën e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesit dhe përgatitjen për testimin e formimit të përgjithshëm dhe shkencor të kandidatit.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MAS-i ka vendosur për kandidatët që testohen. Programi përcakton njohuritë dhe aftësitë kryesore sipas fushave të mëposhtme:

- Dokumente zyrtare¹ të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore - edukative të mësuesve.
- Programe lëndore të historisë.
- Aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në mësimdhënie-nxënie.
- Aspekte të etikës dhe të komunikimit.
- Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- Përmbajtja shkencore sipas programeve lëndore të historisë.

¹Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MAS-it që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.



QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e informatizuar “Mësues për Shqipërinë” të lëndës së historisë është hartuar për të mbështetur dhe nxitur zhvillimin profesional të tyre. Ai ofrohet si një program orientues për t’u ardhur në ndihmë të gjithë kandidatëve dhe mësuesve të lëndës së historisë në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese.

Programi synon:

- rritjen e përgjegjshmërisë së kandidatëve dhe të mësuesve për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës arsimore;
- rritjen e kompetencave profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor;
- rritjen e aftësive në fushën pedagogjike për mësimdhënie strategjike, për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorimin e teknikave për vlerësimin e nxënësve etj.;
- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për domosdoshmërinë e njohjes së koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- rritjen e aftësive të mësuesve në drejtim të zbatimit me saktësi të rregullave drejtshkimore të shqipes;
- demonstrimin konkret të aftësive shkencore dhe kompetencave të fituara, në mënyrë të veçantë nëpërmjet vlerësimit të arritjeve përmes testimit.



PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e kandidatëve të historisë është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër. Për secilën fushë, përpos kompetencave profesionale, janë renditur edhe njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojnë mësuesi i lëndës së historisë.

Përshkallëzimi i njohurive dhe aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë të testimit, do ta ndihmojnë kandidatin (mësuesin) që të identifikojë nevojat e tij, si dhe çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Sipas këtij formati, për **secilën fushë prezantohen kompetencat dhe rezultatet** që priten të zotërojnë mësuesi në fushën e njohurive dhe aftësive, **si dhe literatura përkatëse rekomanduese** që u vjen në ndihmë për zotërimin e këtyre kompetencave.

FUSHA: DOKUMENTE ZYRTARE

Kompetenca “Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe të dokumentacionit shkollor”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i historisë:</i> - zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar, si dhe dispozitat normative të këtij sistemi; - zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e	- Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. - Urdhër Nr. 31 datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”. - Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin

kurrikulës shkollore; - zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës; - demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MAS-it në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie-nxënies; - zbaton etikën profesionale të mësuesit; - respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit; - respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit; - zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit.	e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar” i ndryshuar. - Udhëzimi nr. 17, datë 22.07.2024. “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë”. -Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”. -Udhëzimi nr. 16, datë 22.07.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”. - Urdhër Nr.6, datë 10.01.2018 për zbatimin e nismës “Tri lëndë në gjashtë orë”. - Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.
---	---

FUSHA: PROGRAME LËNDORE

Kompetenca “Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të historisë në shkollë”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i historisë:</i> - zbaton programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij; - përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim; - përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programit; - gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program; - gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxisin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre; - harton rezultate të nxëni për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, në përputhje me kompetencat e programit; - tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të historisë); - shpjegon lidhjen program-tekst nxënësi; - përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e kompetencave; - siguron informacion që demonstroi lidhjen e historisë me shkencat e tjera dhe me jetën reale.	- Korniza Kurrikulare, 2014. - Kurrikula bërthamë AMU, klasat VI-IX, 2014. - Kurrikula bërthamë AML, klasat X-XII, 2016. - Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat VI-IX dhe klasa X -XII.

FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-UT NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE

Kompetenca I “Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e historisë”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i historisë:</i> - demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij; - përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve; - demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit; - identifikoi nxënësit me nevojë të veçanta (nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar); - planifikoi punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me nevojë të veçanta; - demonstroi qëndrim pozitiv ndaj lëndës së historisë; - edukoi të nxënësit dashurinë dhe kërkuesin ndaj lëndës së historisë; - motivoi nxënësit duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre; - krijoi klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit; - punoi me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit.	- Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015. - Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017 - Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz 2016. - Udhëzues për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz, IZHA 2018. - Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së historisë në arsimin e mesëm të ulët, dhjetor 2018. - Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së historisë në arsimin e mesëm të lartë, dhjetor 2018. - .

Kompetenca II “Përdorimi i metodave dhe i strategjive efektive në mësimdhënien e historisë”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i historisë:</i> - përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një objektivi të caktuar; - përdor metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur e krijues të nxënësve; - planifikon një orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin; - përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve; - përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen; - zhvillon kompetencat dhe konceptet kyçe të historisë në mësimdhënien – nxënien e historisë; - demonstroi teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit; - shpjegon parimet e hartimit të një testi.	- Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017 - Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz 2016. - Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), IZHA, 2016. - Udhëzues për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz, IZHA 2018. - Vlerësimi i nxënësit në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë. (<i>Material shpjegues në ndihmë të shkollave</i>), shtator 2019. - Udhëzuesi kurrikular lëndor i historisë në arsimin e mesëm të ulët, dhjetor 2018. - Udhëzuesi kurrikular lëndor i historisë në arsimin e mesëm të lartë, dhjetor 2018. - Modele pyetjesh nga mësuesit për mësuesit, ASCAP 2021, Lënda: histori.
Kompetenca III “Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në histori”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme	- Urdhër për miratimin e “Standardeve

<i>Mësuesi i historisë:</i> - prezanton materiale historike duke përdorur teknologji të përshtatshme si: PowerPoint, Excel, Word; - nxit nxënësit të bëjnë prezantime në histori duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta; - gjen dhe përdor materiale nga Website për të pasuruar dhe perfeksionuar mësimdhënie-nxënien; - përfshin nxënësit në projekte kurrikulare të lëndës së historisë apo në projekte kurrikulare të integruara, të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materialesh nga Website.	profesionale të mësuesit për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit”, nr. 84 datë 06.05.2021. - Material ndihmës për mësuesit lidhur me përdorimin e platformave online në procesin mësimor, ASCAP 2021 -
--	---

FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT

Kompetenca	Literatura e rekomanduar
“Zbatimi i rregullave të etikës dhe të komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”	
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i historisë:</i> - njeh rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin; - sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin	- Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar. - Urdhër nr. 46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.

gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.	
---	--

FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i historisë:</i> - njeh rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe; - demonstroi zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor.	- Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.

FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS

Kompetenca “Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndës së historisë”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i historisë:</i> - dallon konceptet dhe shprehjet kryesore me të cilat operon lënda e historisë në klasat 6-12; - përshkruan mënyrën e formimit të koncepteve historike në klasat 6-12; - përshkruan zhvillimin vertikal, nga njëri vit në tjetrin, të koncepteve dhe të shprehjeve; - dallon ndërvarësinë e koncepteve historike nga	- Programe dhe tekste të lëndës së historisë për mësuesin dhe nxënësin, si dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës për klasat VI-IX për arsimin e mesëm të ulët dhe X - XII për arsimin e mesëm të lartë.

njëri - tjetri dhe lidhjen me konceptet e lëndëve të tjera; - përdor me saktësi dhe në situata të ndryshme konceptet dhe aftësitë e programeve të klasave 6 - 12; - kërkon dhe mbledh informacion të saktë e bindës për nxënësit e tij rreth vlerave përdoruese të historisë në shkencat tjera dhe në jetën e përditshme.	
---	--

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**



Rruga "Naim Frashëri"
Nr. 37
Tiranë
Shqipëri

(+355) 4256440 / 4256441

sekretaria@ascap.edu.al

www.ascap.edu.al